



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 890 prot.

Pogradec, më 1702, 2026

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Z. MANJOLA KAMOLLI

KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:

"PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 12 HA DHE 2200 METRA, E NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE BUÇIMAS QË MUND TË JEPEN ME QIRA."

Me respekt,

KRYETARI

Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1 (Një)

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2 (Dy)

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 4 (kater)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. ____ prot.

Pogradec, më ____ . ____ 2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____, DATË ____/____/2026

PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 12.2200 HA, E NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE BUÇIMAS QË MUND TË JEPEN ME QIRA.

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore", neni 2 i ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqëzimin e udhëzimit nr. 3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave "Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

- 1.Të miratojë listën e sipërfaqes së tokës bujqësore prej **12 Ha** (Dymbëdhjetë hektar) dhe **2200 m²** (dymije e dyqind metra),të ndodhur në Njësinë Administrative Buçimas, që mund të jepen me qera sipas listës.

Nr	Pronësia	Z K	Nr Pasurisë	Vol	Faqe	Vëndodhja	Sip m2	Lloji
1	Shtet	3745	324	6	92	Vërdovë, Buçimas	122200	Arë
TOTALI							122200	

- 2.Toka Bujqësore që do të jepet me qera do te shfrytëzohet vetëm për veprimtari bujqësore dhe te tjera veprimtari ne funksion te saj.
- 3.Afati i dhënies me qera do të jetë në përputhje me destinacionin e kultivimit por asnjëherë më i gjatë se afati i përcaktuar pikën IV të Udhëzimit nr. 1, datë:18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara".
- 4.Çmimi dysHEME i vlerës së qerasë nuk do te jete jo më pak se 6000 (gjashtëmije) lekë Ha në vit sipas pikës nr 10 të Udhëzimit nr. 1, datë:18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara".
- 5.Per zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Bordi qeradhenies tokes bujqesore , si dhe Njësia Administrative Buçimas .
- 6.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETAR
MANJOLA KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Nr. 840 Prot.

Pogradec, më 17.02.2026

Relacion

PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 12 HA DHE 2200 METRA, E NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE BUÇIMAS QË MUND TË JEPEN ME QIRA.

Të nderuar!

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore", neni 2 i ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqëzimin e udhëzimit nr. 3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave "Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe ne zbatim te urdherit nr 733 prot datë 21/09/2020 të Kryetarit të Bashkisë të vënë në zbatim me Memo me nr prot 3579 datë 03/08/2021, ligjit 57/220 "Per pyjet", VKM nr 559 date 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave per dhënien në përdorim të fondit pyjor kombëtar, per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore" sektori i verifikimit te titujve te pronesis dhe shpronësimeve ne bashkepunim me Njesine administrative Dardhas ka evidentuar dhe listuar nje numër pasurish që mund të jepen me qira të sipërfaqes prej **12 ha dhe 2200 metra** të ndodhur në Njësinë Administrative Buçimas. Në referim të Udhëzimit nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqëzimin e udhëzimit nr. 3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", Bashkia Pogradec para se të kerkojë në Këshillin Bashkiak miratimin e listës ka kryer verifikimin e faktit se keto sipërfaqe kane zërin kadastral tokë bujqësore Are, dhe se kjo pasuri preken nga persona private apo ka pretendime.

Gjithashtu theksojmë se kjo pasuri **nuk është pjesë e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 995, datë 9.12.2015 Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 926.55 ha, në pronësi shtetërore, dhënë në përdorim komunave Buçimas, Çërravë dhe Udënisht dhe për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 4.4.2012, nr. 417, datë 8.6.2011 dhe nr. 534, datë 1.5.2008.**

Gjithashtu **kjo parcele nuk është pjesë e Vendimit Nr. 770, datë 12.11.2014 për kalimin në fondin e kompensimit fizik, në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 23 368.8 ha, në pronësi shtetërore, dhënë në përdorim të njësive të qeverisjes vendore, vendim që në Bashkinë Pogradec prek një sipërfaqe prej 1990,64 ha përkatësisht Njesia Administrative Velcan 391,35 Ha, Njesia Administrative Buçimas 238,11 Ha, Njesia Administrative Çërravë 50,09 Ha, Njesia Administrative Trebinjë 282,66 Ha, Njesia Administrative Dardhas 516,13 Ha, Njesia Administrative Proptisht 445,45 Ha dhe Njesia Administrative Udenisht 66,85Ha,**

Gjithashtu kjo sipërfaqe toke **i kanë kaluar në perdorim** ish Komunes Buçimas, me Vendimin nr.244, datë 04.04.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës perfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Buçimas, të qarkut të Korçës".

¹Bulevardi "Rreshit Çollaku", Lagja: Nr.2, Tel: +355 (83) 222222, Fax: +355 (83) 222441, E-mail: bashkiapogradec@gmail.com

Gjithashtu theksojmë faktin se në zbatim të V.K.M-së nr. 510, datë 10.6.2015 " Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial" të gjitha të drejtat e pronësisë që iu takonin ish- Komunave tani i takojnë Bashkisë Pogradec.

Në këto kushte dhe bazuar në nënin 54 gërma "e" të ligjit 139/2015 "Per vetëqeverisjen vendore", nr. 531, datë 21.08.1998 "Për tokat bujqësore të pandara" i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqëzimin e udhëzimit nr. 3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012 , të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara" i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë listën dhe sipërfaqet përkatëse të parcelave që mund të jepen me qera , të ndodhur në Njësinë Administrative Buçimas, sipas tabelës dhe sasisë totale të pasqyruar në projektvendim

Në referim të bazës ligjore nga Drejtoria e emergjencave, strehimit dhe administrimit tokës bujqësore në njësitë administrative, Sektori trajtimit titujve pronësish dhe shpronësimeve, u krijojnë korrespondencat dhe dokumentacioni përkatës me Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrotjtjes së Tokës në Qark, Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë, Angjesinë Shtetërore të Kadastres Drejtoria Vendore Pogradec dhe Njësinë Administrative për të zbatuar sa më mirë dhe Udhëzimin e Këshillit të Ministrave për dhënien me qera të këtyre sipërfaqeve dhe zbatimin edhe të urdherave që ka nxjerre Kryetari i Bashkisë për zbatimin sa më të mirë dhe transparent të këtij Udhëzimi, duke përgatitur shkresat dhe modelet e akteve të verifikimit dhe njoftimet që njësitë administrative kanë administruar dhe do marrin nga ana jone për të bërë procesin sa më transparent për publikin dhe palet e interesuara. Pas gjithë këtij procesi u bë regjistrimi i pasurisë dhe konsultimi publik organizuar nga Këshilli Bashkiak në datë 03.12.2025, pranë Njësisë Administrative Buçimas ku nuk ka patur asnjë kundërshtim apo pretendim për këtë pasuri.

Duke qenë se janë kaluar të gjitha hapat e nevojshme ligjore kërkojmë miratimin tuaj për vazhdimin e procedurave ligjore.


Ju faleminderit!

Konceptoi Kristian MENKSHI

Miratoi: Nexhmi TORRA

Konfirmoi Dritan BABASULI

**KRYETAR
ILIR XHAKOLLI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI

PËRFITUESI I SË DREJTËS (qiramarrës, enfiteozmarrës, kreditorhipotekor, etj)	
Emri(emër, atësidhembimërm)/emriipersonitjuridik	Nr. Personal ID/NIPT
BASHKIA POGRADEÇ	K44802605R

Numri i pasurisë	324		
Kodi unik i pasurisë	3745006092		
Zona Kadastrale	3745		
Lloji i pasurisë	ARE		
Sipërfaqja e pasurisë	122200 m ²		
Sipërfaqja, ose pjesa takuese e pasurisë, që është objekt i të drejtës reale	122200 m ²		
Afati i të drejtës	-		
Adresa e pasurisë	Pogradec		
Pronari/ Bashkëpronarët (qeradhënës, enfiteozdhënës, etj)	Emër, atësi, mbiemër ose emri i personitj uridik	Nr. Personal ID/NIPT	Pjesa (-/-)
SHTET			1/1

DREJTORI
ZHULJEN MANELLARI

Data e Lëshimit 07.07.2025

Denis
Muci

Digitally signed by:
Denis Muci
Date: 2025.07.07
09:47:48 +02'00'

Eugen
Alinj

Digitally signed by:
Eugen Alinj
Date: 2025.07.07
10:21:40 +02'00'

Zhuljen
Manellari

Digitally signed by:
Zhuljen Manellari
Date: 2025.07.09
04:41:08 +02'00'




Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Pogradec
Date: 2025/07/07 09:47:34 +02'00'
K44802605R2025070709472792014

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS



KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 3745006092

(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 3745, Lloji i Pasurisë: ARE, Nr. i Pasurisë: 324/, Sipërfaqja Totale 122200 m2,
(Nga të Cilat Truall 0 m2; Ndërtesë 0 m2)

Indeksi i Hartës Kadastrale K-34-114-(84-D), Numri i Pemëve: 0,

Adresa e Pasurisë: Bashkia VERDOVE, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Vlera e Pasurisë:

Fillestare _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: SHTET, Nr. Identifikimi/NIPT R0000000SH, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: P

Adresa e Pronarit: Bashkia _____, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. LN.01.1996, Datë: 07/05/1996


**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT
07205	07/07/2025	Përdorim	VKM për të drejtën e administrimit/përdorimit	244	04/04/2012	999 vite	BASHKIA POGRADEC	K44802605R

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi:

DREJTORI
Zhuljen Manellari

Denis
Muci

Digitally signed by:
Denis Muci
Date: 2025.07.07
09:48:16 +02'00'

Eugen
Alinj

Digitally signed by:
Eugen Alinj
Date: 2025.07.07
10:21:04 +02'00'

Zhuljen
Manellari

Digitally signed by:
Zhuljen Manellari
Date: 2025.07.09
04:41:32 +02'00'




Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Pogradec
Date: 2025/07/07 09:48:00 +02'00'
K44802605R2025070709475349ASHK

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS



FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE



ZONA KADASTRALE: _3745

KODI UNIK: 3745006092

NUMRI PASURISË :324

INDEX I HARTËS:K-34-114-84-B;D;85-A;C

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



84-D)

SH 1:5000




Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Pogradee
Date: 2025/07/07 10:19:57 +02'00'
K44802605R2025070710195118014

D
ZHULJEN MANELLARI

SHPJEGUES
□ PARCELA

HARTOGRAF

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI**

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 03/12/2025 **Ora :** 10 / :00 **Vendi:** Njësia Administrative Bucimas

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 21 banorë

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :

PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 37 HA DHE 6620 METRA, E NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE BUÇIMAS DHE TREBINJË QË MUND TË JEPEN ME QIRA.

Pjesëmarrës :

Klea Topa (Kryetare e Komisionit juridik)

Vjollc Pllaha (Këshilltare)

Nexhmi Torra (Specialist I Bashkisë)

Jona Bojko(Sekretare e Këshillit)

Nexhmi Torra (Specialist I Bashkisë) bëri një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- Projekt-aktin e propozuar dhe realcionin shoqërues.
- Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik.
- Shtroi pyetjet konkrete që ka për pjesëmarrësit.
- Jep informacion për adresat ku mund të dërgohen rekomandimet dhe afatin përkatës.
- Tregoi kalendarin e konsultimi publik dhe sqaroi procedurën si do të trajtohen rekomandimet.

Z.Torra: Kemi përgatitur një projekt-vendim për Këshillin Bashkiak ku Njësia Administrative Bucimas ka 15 pasuri përkatësisht dy në fshatin Guras dhe 15 pasuri në fshatin Tushemisht. Këto sipërfaqe toke **i kanë kaluar në perdorim** ish Komunës Buçimas, me Vendimin nr.244, datë 04.04.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës perfundimtare të pronave të

paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës **Buçimas**, të qarkut të Korçës". Gjithashtu theksojmë faktin se në zbatim të V.K.M-së nr. 510, datë 10.6.2015 " Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial" të gjitha të drejtat e pronësisë që iu takonin ish- Komunave tani i takojnë Bashkisë Pogradec. Përkatësiht janë grupi i parcelave që janë mbi fshatin Tushemisht tek vendi i quajtur ish-Gurorja. Nga verifikimet që kemi bërë tek zyra e regjistrimit del që janë Toka-shtet por nqs dikush ka dokumentacion pronesie pra ndnj AMTP të paregjistruar mund të na vendosë në dijeni.

Zamir Goroveci: Për parcelat në fshatin Guras kush është i interesuar?

N.Torra: Këtu nuk kemi individë të vecantë të shprehin interes, nuk ka persona konkretë për momentin.

Ilir Tasellari: Per mendimin tim ky procesi i dhënies së tokave me qera i acaron pak banorët. Të flasim drejt dhe Bashkia ka të drejtë të japë me qera rokat të cilat janë të vetat dhe qe nuk po shfrytëzohen. Mendoj që duhet të bëhen gjërat më transparente, të dalin me njoftim të gjitha tokat që janë për tu dhënë më qera dhe të konkurojnë për ti marrë personat që janë të interesuar, Unë personalisht kam që në vitin 2021 që kërkoj të mar disa toka me qera dhe nuk më japin asnjë përgjigje.

Zamir Goroveci: Kryetarja e Këshillit na tha që do tju jepet përparësi banorëve. Në varezat e qytetit u dhanë ca toka me qera , personi qe i mori i kishte bërë dokumentat gati me përpara dhe erdhi i mori. Pra një person nga fshati Zdërvaskë mer tokat e fshatit Zagorcan. Pra në këto raste duhet ti jepet përparësi fillimisht banorëve të zonës.

K.Topa : Nga ana e Bashkisë paraqitet një listë me sipërfaqet e tokës që janë për tu dhënë me qera në bazë të kërkesave që janë bërë.Këshilli ju paraqet banorëve dhe shpjegon procedurat dhe mer vendimin për ti hapur rrugën Bashkisë për ti dhënë tokat me qera.Nuk e vendos Keshilli kush do i marrë tokat me qera, detyra jonë është të vërtetojmë që nuk ka pronarë me AMTP të vjetër të paregjistruar.

Z.Xhemollari: Unë e kam tokën e gjyshit dhe nuk e regjistroj dot vetëm sepse duhen shumë lekë për regjistrim.

Valter Cinari: Tek Luadhi Celos ne kishim toka por na i morën dhe tani ato as nuk shfrytëzohen asgje.

Zamir Goroveci: Pasuria nr 146 është vendosur 300 m2 ndërkohë që ajo është 1000 m2 dhe atë e përdorin banorët.

I.Tasellari: Nqs ju e jepni me qera jepjani personave që e kanë.

N. Torra: Duhet të interesohen vetë banorët.

z.Sami: Kam shumë vjet që interesohem për një tokë.

N.Torra: Përsa i përket Luadhit të Celos, është pronë e Ministrisë së Bujqësisë me VKM 995. Kemi kërkuar shfuqizimin e VKM dhe nuk na është kthyer asnjë përgjigje. Zotëria që e ka , e kka prishur kontratën.

N. Torra: Secili që ka AMTP për këto pasuri të na vendosin në dijeni. Përsa i përket pasurisë nr 146 mund ta heqim nga lista, ose e vendosim dhe ta marrë kush është i interesuar.

Afati kohor i dhënies së tokave me qera është në varësi të Planit të biznesit , vlera e qerasë është në varësi të bonitetit.

Sali Cela: Dëgjuam që do mjepet me qera dhe nje tokë afër kanalit vaditës në fshatin Guras, a është e vërtetë?

N.Torra: Jo nuk preket ajo pjesë.

Aurel Spahiu: Jam një dermer që jam i interesuar për të marrë toka me qera, por nuk e kam të qartë procesin.

Beqir Cinari: Kam dy parcela mbi pularinë, kam tokën e babit të cilën e ka marrë me vendim gjykatë. 1 parcelë në kufi me Tushemishtin është regjistruar. Janë 4-5 ha të mbjella me pemëtore dhe thonë që ja kanë dhënë dikujt.

Armando Cake: Kam mbjellë qershi ka 25 vjet dhe ka ardhur një zonjë e cila thotë që e kam unë.


Z.Goroveci: Unë erdha si përfaqësi e fshatit Zagorcan. Përparësi duhet tju jepet banorëve të fshatit. Nqs ata nuk shprehin interes ta marrë kush është i interesuar.

N.Torra: Në përgjigje të kësaj, me marrjen e vendimit do presim 25 ditë , do sjellim dokumentat që të kemi kohë.

SEKRETARE E KËSHILLIT

Jona BOJKO





**R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI**

Procesverbal

Konsultim publik :

Data : 04/12/2025 **Ora :** 10 / :00 **Vendi:** Njësia Administrative Trebinjë

Numri i pjesëmarrësve : Gjithësej 27 banorë

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet :

PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 37 HA DHE 6620 METRA, E NDODHUR NË NJËSINË ADMINISTRATIVE BUÇIMAS DHE TREBINJË QË MUND TË JEPEN ME QIRA.

Pjesëmarrës :

Vjollca Pllaha (Këshilltare)

Odhise Mihallari (Këshilltar)

Kristjan Menkshi (Specialist I Bashkisë)

Geront Oshafi(Specialist I Bashkisë)

Suela Mertkola (Punonjësë Sekretarjati)

Kristjan Menkshi (Specialist I Bashkisë) bëri një prezantim të shkurtër për përfaqësuesit e Bashkisë. Qëllimi është të bëjmë një dëgjësë për dhënien e tokave në përdorim. Procedurat janë ashtu sic ju jeni vënë në dijeni, duhet të zhvillojmë dëgjësën publike për tju informuar. Ne jemi të hapur edhe për kërkesa të tjera, kush ka dëshirë nga zona juaj edhe është i interesuar për tokat e lira ne jemi të hapur. Ja japim fjalën Gerontit për tju sqaruar më shumë për dy parcelat përkatëse.

Geront Oshafi (Specialist I Bashkisë) Z.Nikolla Bakollari ka aplikuar pranë Bashkisë për dy parcela me qera, ai momentalisht I punon këto parcela, për të qënë në rregull edhe me ju edhe me Bashkinë duhet të bëjë kërkesën tek ne, Të njëjtën procedurë mund të ndiqni edhe ju. Kush ka ndonjë kundërshtim për këto parcela jemi të gatshëm tju dëgjojmë. E njëjta procedurë do ndiqet me të gjithë ju pasi keni bërë aplikimin në Bashki.

Të parët që kanë përparësi për të aplikuar për tokat e lira janë banorët e zonës.

Banor I zonës: Kemi probleme se më pas ne mund të hajmë kokat me njëri tjetrin.

Odhise Mihallari: Po flasim për tokat e lira, jo për tokat që kanë pronar.

Banor I zonës: Në rregull.

Geront Oshafi (Specialist I Bashkisë) ju letem më dëgjoni pak që mos ndodhin keqkuptime këto toka duhet të jenë toka buqësore edhe ne AShK duhet të jenë të lira pa pronar. Ne jemi vetëm për tokat buqësore.

Banor I zonës 1: Unë dua të aplikoj sa është vlera e aplikimit?

Geront Oshafi (Specialist I Bashkisë) Vlera është 7000 të vjetra në vit.

Vjollca Pllaha (Këshilltare) Kemi erdhur këtu për tju dëgjuar dhe për të rënë dakort për këto dy parcela, ju lutem duhet të flasim për këtë, kush ka kundërshtim të thotë. Në fund po të keni dicka të paqartë e themi dhe ju a shpjegojmë. Të kuptohemi mos kalojmë në problemet e tjera për të mos u ngatëruar dhe dalim jashtë qëllimit që ne kemi erdhur.

Banor I zonës 2: Ne nuk kemi problem për dy parcelat në fjalë, me sa di unë ato parcela kanë qënë gjithmonë të familjes pavarësisht që nuk I ka me dokumenta. Ne nuk duam që tokat tona të merren nga njerëz të tjerë që nuk janë nga zona dhe nga fshati jonë.

Banor I zonës 3: Të jemi ne të parët që do informohemi për cdo parcel që do lëshohet me qira dhe më pas të vijnë të tjerët.

Geront Oshafi (Specialist I Bashkisë) Ju falenderoj për prezencën tuaj, ashtu sic e thamë edhe më lart cdo kush nga ju mund të bëjë kërkesë për tokat që janë të lira.

Protokolloi : Suela Mertkola

SEKRETARE E KËSHILLIT

Jona BOJKO